REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 74/17
15-03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: *MINISTRIA E SHENDETESISE*

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **206-16-047-111**

Sa i përket tenderit për: "Furnizim me barna nga L.E."

Për Lot:32. (Salbutamol Plv,per Inhalim 100mcg /doze 200 doza per inhalim)

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

N.T.P."ICN&BM"

Rr:"NDUE PERLLESHI "Pa Nr.

PRISHTINE *10000*

045-302-141 *038- 516-223*

i autoriz.Bejtush Gashi

bejtush.icnbm@hotmail.com

13.03.2017.

ICN&BM PHARMACEUTICAL WHOLESALERS Office Prishtinë - Kosova

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi për Kontrate me 16.06.2016
Data e lëshimit te dosjes se tenderit 06.07.2016
Data e mbylljes 22.08.2016
Shtyrje te afateve te hapjes se tenderit: Disa here vazhdimisht
01.08.2016
05.08.2016
22.08.2016
Data e Hapjes se Tenderit : 22.08.2016 (14:30)
Njoftim për dhënie te kontratës për disa llote :10.11.2016
Njoftimi për anulim te aktivitetit : ***Nuk ka pasur***
Kriter për dhënie te kontratës : Çmimi me i ulte

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] **Jo** [ ]

Procesi i hapjes ka qene ne rregull konform rregullave dhe ligjit ne fuqi te LPP-se

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime

shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po ☐ Jo ☒

AK nuk ka publikuar asnjë njoftim lidhur me eliminimin për ndonjë nga llotet e këtij tenderi me titull: "Furnizim me Barna nga L.E", dhe numër të prok:206-16-047-111. Ndërsa, edhe pse afati ligjor për vlerësim te ofertave është tejkaluar dhe përkundër shkresave te adresuara nga ana jone ne nuk kemi pranuar asnjë përgjigje nga AK ne lidhje me ketë tender, gjegjësisht për Lot 32.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Duke marrë për bazë faktin se ne nuk kemi marrë asnjë përgjigje në lidhje me procesin e vlerësimit të këtij tenderi, gjegjësisht Lot 32, i cili ka të bëjë me (Salbutamol Plv.per Inhalim 100mcg /doze 200 doza per inhalim), parashtrojmë këtë ankesë pranë OSHP-së në bazë të Par 1 të nenit 109 të ligjit 05/L-068, si më poshtë:

Edhe pse, sipas përshkrimit të bërë në pikën 3 më lartë, ka skaduar çdo afat i mundshëm për vlerësimin e ofertave dhe pasi ne nuk kemi marrë asnjë njoftim lidhur me: Njoftimin për Dhënie, Njoftimin për Anulim apo përfundimin e aktivitetit të prokurimit për llot 32 në pajtim me dispozitat ligjore të LPP-së, mendojmë së AK ka rënë ndesh me dispozitat ligjore si më poshtë:

- AK me datë 09.11.2016 shpall njoftimin për Dhënie të Kontratës për disa nga llotet e këtij tenderi, përjashtuar Llotin 32 me të cilin ka të bëjë kjo ankesë. Përmes këtij veprimi, AK ka rënë ndesh me par. 1 dhe 2 të nenit 7 (Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi) të LPP-së.

- Zyrtari i prokurimit pranë AK kishte kërkuar disa herë vazhdimin e validitetit të ofertës, ku ne si OE kishim vazhduar validitetin e ofertës çdo herë që kërkohej nga AK, ku herën e fundit ishte kërkuar nga AK që të vazhdohet validiteti i ofertës deri me datë 27.10.2016. Duke marrë për bazë afatin e fundit të validitetit të ofertës (27.10.2016), AK ka tejkaluar çdo afat të lejuar ligjor për vlerësimin e ofertave, veprim i cili bie në kundërshtim me par. 4 të nenit 17 të Rregullores për Prokurim Publik.

- Mos ndërmarrja e veprimeve nga AK sipas dispozitave ligjore të LPP-së, gjegjësisht mos përmbyllja e këtij aktiviteti të prokurimit për këtë Llot, është në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së, prandaj konsiderojmë se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 62 të ligjit 05/L-068, sipas të cilit nen përcaktohet se në cilat kushte mund të bëhet përfundimi i aktivitetit të prokurimit.

Duke u bazuar në shkeljet e specifikuara më lartë, mos veprimit të AK në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktuara në legjislacionin primar dhe sekondar, si dhe duke u bazuar në parime bazë të prokurimit, kërkojmë nga OSHP-ja që të shqyrtojë ankesën tonë, duke e obliguar AK që të vazhdojë më procesin e vlerësimit për Llot 32 (Salbutamol Plv, per Inhalim 100mcg /doze 200 doza per inhalim) dhe përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Sipas proces verbalit te hapjes së ofertave, shihet qarte se ne kemi qene Operatori ekonomik i përgjegjshëm me ofertën më të lirë për llotin 32 të këtij aktiviteti të prokurimit.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Duke pasur parasysh që ky tender ishte shpallur me 16.06.2016, dhe pas hapjes së ofertave kemi mësuar se jemi OE me çmimin më të ulët për llot 32, ne kemi bërë porosinë e mallit, dhe mos përfundimi i këtij aktiviteti të prokurimit për llot 32, do të na shkaktonte humbje materiale dhe rrezikim të biznesit.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe
e) të gjitha korrespondencat e jnaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*